



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

www.komuna-kline.org



Duke u mbështetur në nenit 73 të LVL nr.03/L-040, dispozitat e Udhëzimit Administrativ të MAPL nr.2008/10, nenit 36 pika 3 të Statutit të Komunës, nenit 5, 6, 7 dhe nenit 8 pika 5, të Rregullores komunale për Komitetet Konsultative, me Preferencat e Komitetit për Politikë dhe Financa të dt.12.11.2012, Kuvendi i Komunës së Klinës më dt.30.11.2012, shpall përsëritjen e

KONKURSI

Për emërimin e 1/3 së anëtarëve të Komiteteve Konsultative .

Për anëtarësim në Komitetet konsultative, si vijon:

- Komitetin për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Mbrojtje të Mjedisit,
- Komitetin për Çështje Emergjente.

Komitetet Konsultative duhet të emërojnë çdo vit 1/3 e anëtarëve , me qëllim të transferit dhe kontinuitetit të njohurive profesionale për sigurimin e qëndrueshmërisë së propozimeve dhe mendimeve.

Përbërja:

Komitetet përbëhen nga përfaqësuesit e shoqërisë civile dhe OJQ-ve.

Për pjesëmarrje në takime anëtarëve të komiteteve iu bëhet kompensimi konform Udhëzimit Administrativ, nr.16/2008.

Anëtarët e Komiteteve Konsultative duhet t'i plotësojnë këto kritere:

- Të kenë përgatitje superiore profesionale, apo ndonjë titull tjetër nga lëmi apo fushëveprimtaria përkatëse e komitetit,
- Të këtë përvojë të mjaftueshme praktike në hartimin e propozimeve profesionale, hulumtimeve dhe mendimeve,
- Të jenë banorë të Komunës së Klinës.

Afati:

Konkursi është i hapur 15 ditë nga dita e publikimit.

Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Zyrën e Shërbimit për Punë të Kuvendit të Komunës-Klinë.

KUVENDI I KOMUNËS KLINË

01Nr. 111-4842/12
Klinë, më 05.12.12



Kryesuesi,
Fadil Gashi